

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Polemikat për manekinin e Çerçiz Topullit, jep dorëheqjen kreu i Agjencisë së Trashëgimisë Kulturore në Gjirokastrë: Përgjegjësia është e imja
ADRESA	https://newsbomb.al/aktualitet/polemikat-per-manekinin-e-erciz-topullit-jep-doreheqjen-k-reu-i-agjenc-i401605
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 10:31:39 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 10:16:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	341931305c5788083e417a148eff65f4a62c9d7a4d8255f6f699290103a61852
TEKSTI	bc5ee5d6263a8c36867c624737a0cb69643cded81b73ce905b55e751d5735721
PAMJA	01de800168e7408f460c6cbfe0b108c1fdee2d3127b83b520dbe4897d6822217

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	50b2f794fe3f87a0813834c29774d858ac5cf1a57b5365e6ec997a0880041b76
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a0b332b3aa7ecfa1fb91f9dd35095ec558c07d306f6207fe4bc42429a4dfb028
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/50b2f794fe3f87a0813834c29774d858ac5cf1a57b5365e6ec997a0880041b76>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Çështjet kryesore

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

Aktualitet

19 Shtator 2026, 12:16

Polemikat për manekinin e Çerçiz Topullit, jep dorëheqjen kreu i Agjencisë së Trashëgimisë Kulturore në Gjirokastrë: Përgjegjësia është e imja



Shkruar nga Newsbomb



Florian Hysi dhe manekini i përfolur

Pas reagimeve të shumta që shkaktoi manekini i Çerçiz Topullit i ekspozuar në Muzeun e Kalasë së Gjirokastrës, kreu i Agjencisë së Trashëgimisë Kulturore në Gjirokastrë Florian Hysi ka njoftuar dorëheqjen nga pozicioni që mbante. Përmes një deklarate publike, Hysi bën të ditur vendimin për t'u larguar, ndërsa thekson se çdo detyrë publike duhet të shoqërohet me përgjegjësi personale për vendimet, veprimet apo gabimet që mund të ndodhin gjatë ushtrimit të saj.

"Ajo që u konsiderua gabim, u korrigjua dhe marr të gjithë përgjegjësinë përsipër", shprehet Hysi në deklaratën e tij postuar në rrjetet sociale.

Dorëheqja vjen fill pas debatit të krijuar një ditë më parë rreth manekinit që synonte të paraqiste Heroin e Popullit, Çerçiz Topullin në Muzeun e Kalasë së Gjirokastrës. Pamja e tij shkaktoi reagime të shumta në rrjetet sociale ku qytetarë dhe figura publike kërkuar largimin e tij, duke e konsideruar paraqitjen të papërshtatshme për figurën historike.

Në deklaratën e dorëheqjes, Hysi nuk e përmend drejtpërdrejt manekinin, por flet për "gabim" që sipas tij tanimë është korrigjuar. Ai falënderon Bashkinë e Gjirokastrës, kolegët, teksa e cilëson largimin e vet si një akt përgjegjësie ndaj institucionit.

Kujtojmë që polemika nisi pasi në Muzeun e Kalasë së Gjirokastrës u ekspozua një manekin që tentonte të rikrijonte pamjen e Çerçiz Topullit, të pajisur me veshje, armë dhe dylbi. Realizimi u kritikua gjerësisht në rrjetet sociale.

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Showbiz & Lifestyle

"Një jetë e tërë në një fotografi", ish-fituesi i Big Brother bëhet baba për herë të parë



Bota

Amerika dhe Danimarka arrijnë marrëveshje për Groenlandën, pas kërcënimeve të Trump për aneksimin e saj

Zbulo më shumë artikuj >

"Deklaratë dorëheqjeje !

Pas një periudhe pune të përkushtuar në shërbim të trashëgimisë kulturore, muzeve dhe Gjirokastrës, kam vendosur të jap dorëheqjen time prej pozicionit që mbaj .

E bëj këtë vendim me përgjegjësi dhe me bindjen se çdo detyrë publike duhet të shoqërohet me përgjegjësi personale për çdo vendim , veprim apo gabim që mund të ndodhë gjatë saj . Ajo që u konsiderua gabim u korrigjua dhe marr të gjithë përgjegjësinë përsipër.

Largohem me mirënjohje për mbështetjen e Bashkisë Gjrokastër , për kolegët dhe veçanërisht për punonjësit e Agjencisë së Trashëgimisë Kulturore , me të cilët kemi punuar dhe realizuar shumë më shumë më tepër sesa ishte bërë prej vitesh.

Dorëheqja ime nuk është dorëzim nga ajo që besoj . Është një akt përgjegjësie dhe respekti për institucionin !

Mbetem mirënjohës për punën e bërë , për përpjekjet tona dhe për çdo gjurmë që kemi lënë në muze dhe në kujtesën e Gjirokastrës.

Do të vazhdoj ta dua dhe ta mbështes Gjirokastrën, trashëgiminë e saj dhe kujtesën tonë kombëtare , në çdo formë që do të më jepet mundësia.

Ne u përpoqëm , atë që u konsiderua gabim e korrigjuam dhe punën do ta lëmë të flasë vetë.

Mirënjohje !

Florian Hysi", shkruan kreu i Agjencisë së Trashëgimisë Kulturore në Gjrokastër në facebook-un e tij.

Këshilluar për ty



Hiqeni këtë dordolec! Rrjeti zien për manekinin e heroit Çerçiz Topulli në Kalanë e Gjirokastrës (THIRRJA PËR MINISTRINË E KULTURËS)

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



🕒 E Shtunë 12:09

Tronditet Tirana! Burri vret me thikë

gruan te Zogu i Zi



Aktualitet

Greqja "kopsit" skenarët për Alket Rizain, tani që u arratis e akuzon edhe për një vrasje brenda në burg

🕒 E Shtunë 12:01



Aktualitet

Të shtëna me armë zjarri në një kantier ndërtimi në Tiranë, plagoset menaxheri i firmës

🕒 E Shtunë 11:53



🕒 E Shtunë 11:26

Reshje shiu me shtrëngata dhe rrezik i moderuar për zjarre, Instituti i Gjeoshkencave thirrje për kujdes në disa qarqe



Aktualitet

Falsifikuan dokumentet për 6 prona në Fier, Prokuroria kërkon "arrest me burg" për ish-drejtorin e ASHK-së dhe përfituesin

🕒 E Shtunë 11:27




Aktualitet

Bordi njofton ÇMIMET E REJA, ulje e fortë e benzinës, ja sa do të shitet nga sot një litër naftë


🕒 E Shtunë 10:45





E Shtunë 09:59

Maratona ndërkombëtare në Korçë, ja rrugët me kufizim qarkullimi në bashkinë e juglindjes



Aktualitet

IKMT fillon prishjen e objekteve në gjurmën e Bypassit të Tiranës, nga Kashari drejt Nyjes së Vaqarrit

E Shtunë 09:40



Aktualitet


11 shoferë të proceduar e të arrestuar në gjendje të dehur, Rugorja e Vlorës me dorë të hekurt: Mbi 2500 gjoba gjatë dy javëve të para të muajit shtator

E Shtunë 09:24



E Shtunë 08:37

Hiqeni këtë dordolec! Rrjeti zien për manekinin e heroit Çerçiz Topulli në Kalanë e Gjirokastrës (THIRRJA PËR MINISTRINË E KULTURËS)



Aktualitet

Diell, vranësira dhe reshje shiu në disa zona, ja si parashikohet moti sot

E Shtunë 07:19



Aktualitet

Nën arrest shtëpie, por shqiptari nuk zë "mend"! Bie sërish në pranga për shitje kokaine

E Premte 23:46





🕒 E Premte 22:51

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.